



02Nr. 486 /2025  
22.01.2025

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197 në nenin 78 paragrafi 2, neni 80 dhe 81, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, (QRK)nr.19/24 Për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, UA (MASHT) nr.18/2023 Për këshilltarët për karrierë në IAP, Komuna Hani i Elezit shpallë:

## KONKURS

**Institucioni:** Komuna Hani i Elezit  
**Drejtoria:** Drejtoria për Arsim

**1. Titulli i vendit të punës:** Këshilltar/e i/e karrierës  
**njësia/ sektori:** SHFMU-ut dhe SHML  
**Numri i pozitave:** Një (1) pozitë me kohë të pacaktuar  
**Koeficienti/Grada:** E19-5.6  
**Orët e punës:** 20 orë

### Detyrat dhe përgjegjësitë për Këshilltar/e i/e karrierës :

- Mbështesin nxënësit e klasave 6-9 me aktivitete të ndryshme në fazat e edukimit për karrierë;
- Mbështesin fazën tranzitore të nxënësve nga kl.9-ta në SHML, duke ofruar informacione dhe këshilla;
- Bashkëpunon nga afër me prindërit e nxënësve të kl.9-ta përmes sesioneve vetëdijësuese për aspekte të ndryshme të vazhdimit të shkollimit të fëmijëve të tyre;
- Vlerëson karakteristikat e individit lidhur me karrierën (përdor intervista, mjetet për vlersim dhe vetëvlersim);
- Ndërmjetëson për nxënësin (identifikon vende të shkollimit, shkathtësitë e nxënësve, mundësi të praktikave, punëve vullnetare etj);
- Kryen edhe detyra tjera sipas UA, dhe detyra tjera sipas drejtorit të shkollës;

### Kushtet e përgjithshme në rekrutim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj të paktën njëherë nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë e/i denuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Të mos ketë fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik

## Kualifikimi për Këshilltar/e i/e karrierës

- Niveli Master 300 ECTS
- Baçelor 240 ECTS
- Niveli i 5-të Pearson për Këshilltarët e Karrierës

## Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje ).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

## Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

-Procedura e vlerësimit bëhet sipas Rregullorës (QRK)nr.19/2024.

## Afati dhe mënyra e aplikimit:

**Pranimi i aplikacioneve bëhet mbrenda shtatë ( 30) ditëve nga data 23.01.2025 deri 21.02.2025 nga ora 08:00-16:00**

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

T ë gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

**Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.**

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezitdhe> në tabelën e shpalljes.

**Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi**

